

## PROCESVERBAL 16/12//2024

I mbajtur me rastin e takimit të 12 (dymbëdhjetë) të rregullt për vitin 2024 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 16.12.2024 duke filluar nga ora 9:00.

### Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor i punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të punës i Kuvendit Komunës në Suharekë;
4. Të ndryshme;

Në mungesë të Kryesuesit të komisionit z. Denis Sofra, takimin e hap znj. Aferdita Morina, përshëndet të pranishmit dhe i njoftoi me rendin e ditës. E hedh në votim rendin e ditës.

**Aprovohet rendi i ditës**

**Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

Aferdita Morina- e hedh në votim pikën 1.

**Aprovohet pika 1**

**Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit vjetor i punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;**

Aferdita Morina-i njoftonë me pikën dhe ja kalon fjalën Zyrtarit ligjor.

**Avni Bytyqi** –përshendet të pranishmit.Unë në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës,si kryesues i Këshillit për Siguri në Bashkësi dhe me arter kryesor të Siguris kemi arritë të hartojmë një plan veprimi për Siguri në Bashkësi ku sipas udhëzimeve administrative,ne kemi paraparë që edhe për vitin 2025 të kemi 6 takime të rregullta por kemi me diskutu edhe tema të tjera që nuk i kemi planifiku në plan veprimi të KKSB –së.

Aferdita Morina- e hedh në votim pikën 2

**Aprovohet pika 2**

**Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit të veprimit planit të punës i Kuvendit të Komunës në Suharekë;**

**Aferdita Morina-** i njofton me pikën dhe ja kalon fjalën Zyrtarit ligjor.

**Avni Bytyqi-**Edhe ky plan ka të bëjë me planin e punës apo paraplanifikimin e planit të punës të Kuvendit për vitin 2025.Të gjitha temat që jemi të obliguar sipas ligjit dhe rregulloreve që i parashohim në kuader të këtij plani,ne jemi munduar që ti përfshijmë disa tema tjera të cilat nuk jan obligative me ligj por ne e kemi vlerësu dhe e kemi konsideru që në vitin 2025 duhet të miratohen nga Kuvendi i Komunës.Ne jemi munduar që të gjitha ti përfshijmë në kuader të këtij plani.

**Aferdita Morina-**e hedh në votim pikën 3.

**Aprovohet pika 3**

**Pika 4.Të ndryshme;**

**Aferdita Morina-** e hap debatin

Nuk ka debat

Takimi përfundoi: 09:06